

## **Msc . Pranvera Dingo**

### **Përgjegjëse/ Sektori i Shërbimeve dhe Publikimit në ASCAL.**

Msc. Pranvera Dingo ka kryer studimet në Universitetin e Tiranës, Fakulteti Ekonomik, në Degën Financë, duke marrë titullin Ekonomiste në Financë, në periudhën 1985-1989.

Në periudhën 1989-1990 menjëherë pasi ka përfunduar studimet ka punuar në qytetin e Vlorës pranë Ndërmarrjes Tregtare Vlorë (NTSH) si llogaritare e parë në Degën e Financës. Në vitet 1990-1993 transferohet në rrethin e Skraparit ku krijon familje dhe mban detyrën e N/kryetares dhe Kryetares së Degës së Financës në NTSH Skrapar, ku mbulon gjithë veprimtarinë financiare të këtij institucioni.

Në vitet 1993-1998 punon si Kryetare e Degës së Financës pranë Firmës private “Pasioni Shpk”, Tiranë dhe po në këto vite merr titullin “Ekspert kontabël”, detyrë të cilën e ushtron në vitet 1998-2000 ku punon si eksperte kontabël në Projektin e Kryeministrisë në auditimin për Firmat Piramidale.

Zj. Dingo prej vitit 2000-2014 ka një aktivitet të gjatë dhe të pasur në Sektorin Elektroenergjetik Shqiptar, në Korporatën Energjetike Shqiptare (KESH) dhe kompania Elektroenergjetike private CEZ-Albania, pjesë e stafit si kontabiliste, shefe e financës dhe menaxhere në Departamentin Ekonomik (DEK) dhe atë të Kontabilitetit. Ajo ka një kontribut të rëndësishëm në organizimin e këtij sektori si pjesë e menaxhimit të pasqyrave financiare, përpunimin e saktë të informacionit në lidhje me transaksionet dhe standardizimin e raportimeve financiare të kësaj kompanie.

Prej shtatorit të vitit 2014 ajo është pjesë e stafit të ASCAL në pozicionin e përgjegjëses së Sektorit të Shërbimeve dhe Publikimit. Ajo përgjigjet për njohjen, zbatimin dhe kontrollin e ligjshmërisë financiare të administratës së ASCAL, harton buxhetin, menaxhon prokurimet publike dhe kontrollin e ligjshmërisë së tyre, harton Regjistrin e Parashikimit të Prokurimeve Publike dhe realizimin e tij, menaxhon dhe monitoron veprimtarinë financiare dhe kontrollon përdorimin e fondeve publike në mënyre të ligjshme, me ekonomi dhe efikasitet, ndjek e kontrollon gjithë transaksionet e kryera në ASCAL, ndjek dhe menaxhon veprimtarinë e plotë të arkivës dhe protokollit dhe krijon mundësi për lehtësira të nevojshme në korrespondencën protokollare e arkivuese, nëpërmjet informatizimit të plotë të arkivit, Përpilon dosjen personale për çdo punonjës dhe pasqyron në vijimësi vlerësimet, shpërblimet, masat administrative, vjetërsinë në punë, ndryshimet në pagesa, Ndjek dhe monitoron veprimtarinë në lidhje me publikimin e aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe njoftimin e të gjitha të rejave në fushën e legjislacionit tek specialistët e ASCAL,etj.

Znj.Dingo ka qenë pjesë e shumë trajnimeve dhe ëorkshop-eve që kanë të bëjnë me formimin e saj, si : për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë, për Prokurimin Publik, për Procedurat e Prokurimit me Vlerë të Vogël, për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit, për Procedurat Standard të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm, Standardizimin e Raportimit të të Dhënave dhe Pasqyrave Financiare, Risku, Menaxhimi, Përditësimi i Sistemit të Regjistrit Qendror të Personelit (HRMIS), Praktikrat e Zhvillimit dhe Menaxhimi i Ekipit, Nëpunësit e Burimeve Njerëzore për Modulin "Punonjësi", Teknikat menaxhuese bazë të personelit, aktivitete kombëtare

dhe ndërkombëtare në kuadër të sigurimit të cilësisë, dhe aspekte të tjera në fushën e arsimit të lartë etj.